

## **Projektet e tanishme në Ministrinë e Drejtësisë**

### **Fuqizimi i formulimit të politikave, hartimit të legjislacioni, si dhe zbatimi efektiv i tyre**

Financuar nga: Komisioni Evropian (IPA 2014)

Përfitues: Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera relevante

Qëllimi i projektit është fuqizimi i kapaciteteve të formulimit të politikave dhe hartimit të legjislacionit, si dhe implementimi i tyre në Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet tjera relevante.

Implementues: IRZ <http://www.irz-stiftung.de/>

Kohëzgjatja: 01.10.2016 – 01.04.2019

Shuma e projektit: 1,245,546.40 €

Objektivat:

- Fuqizimi i kapaciteteve në hartimin e koncept dokumenteve dhe dokumenteve strategjike në fushën e drejtësisë.
- Fuqizimi i kapaciteteve në hartimin e ligjeve duke zbatuar Acquis.
- Përmirësimi i performancës së departamenteve përgjegjëse të përfshira në hartimin e ligjeve/politikave.

---

### **Mbështetje në hartimin e Kodit Civil dhe trajtimin e çështjeve pronësore, faza II**

Financuar nga: Komisioni Evropian (IPA 2015)

Përfitues: Ministria e Drejtësisë

Qëllimi i kësaj kontrate është të vazhdoj mbështetjen e BE-së për modernizimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor për çështjet civile në përputhje me Acquis të BE-së, standardet evropiane dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dhe të mbështesë zbatimin e një Kodi të ri Civil.

Projekti “Mbështetje për Kodin Civil - Faza II” do të mbështesë Qeverinë e Kosovës në finalizimin e Kodit Civil për Kosovën. Projekti është i ndarë në tri faza: 1. Faza fillestare (tre muaj); 2. Faza e implementimit (36 muaj); dhe 3. Faza e largimit (6 muaj). Ndërsa

faza e implementimit është e ndarë në dy komponenta: a). finalizimi dhe zbatimi i kodit civil

Kohëzgjatja: 01.02.2017 – 31.01.2020

Shuma e projektit: 2,500,000.00 €

---

**Mbështetje Profesioneve të Lira Ligjore dhe Odës së Avokatëve në Kosovë (IPA 2014);**

Financuar nga: Komisioni Evropian (IPA 2014)

Përfitues: Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera relevante

Qëllimi: Funkcionalizimi i plotë i sistemit të profesioneve të lira ligjore duke përforcuar: Departamentin për Profesionet e Lira Ligjore dhe kapacitetet e profesioneve të lira ligjore si dhe Odën e Avokatëve

Implementues: B&S Europe dhe Kosovo Legal Services Company (KLSC)

Kohëzgjatja: 2016 - 2019

Shuma e projektit: 1,398,850.00

---

**Fuqizimi i Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues të Kosovës, faza II (2014);**

Financuar nga: Komisioni Evropian (IPA 2015)

Përfitues: Ministria e Drejtësisë

Qëllimi: Qëllimi i projektit është përmirësimi i standardeve të sistemit sprovues dhe burgjeve në Kosovë duke forcuar menaxhimin efektiv dhe efikas të shërbimeve korrektuese dhe sprovuese në përputhje me standardet demokratike dhe të Bashkimit Evropian.

Implementues: Agjencia e Sanksioneve Penale në bashkëpunim me Institutin Kombëtarë për Shëndet dhe Mirëqenie, Finlandë

Kohëzgjatja: Shtator 2017 – Mars 2020

Shuma e projektit: € 2,000,000.00

---

**Fuqizimi dhe modernizimi i shërbimeve të Forenzikës në Departamentin e Mjekësisë ligjore, faza II (IPA 2015);**

Financuar nga: Komisioni Evropian (IPA 2015)

Përfitues: Ministria e Drejtësisë

Qëllimi: Të mbështesë autoritetet e Kosovës për të forcuar sundimin e ligjit duke mbështetur më tej zbatimin e ligjit në përgjithësi, dhe sistemin gjyqësor transparent, me fokus në shërbimet e mjekësisë ligjore

Implementues: ETI Consulting SAS në Konsorcium me Universitetin e Splitit, Departamenti i Shkencave të Forenzikës; Agjencia Konsultuese Ltd; dhe Kompania me Interes për Zgjidhjen e Qëndrueshme të Drejtësisë Penale Ltd.

Kohëzgjatja: Janar 2017 – Nëntor 2020

Shuma e projektit: € 2,000,000.00

---

**Projekti kundër krimit ekonomik në Kosovë (PECK) II.**

Financuar nga: Bashkëfinancim nga Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian

Përfitues: Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera relevante

Qëllimi:

Implementues: Këshilli i Evropës

Kohëzgjatja: Janar 2016 – Dhjetor 2018

Shuma e projektit: 2,000,000.00

---

**Regjistri Kombëtar Qendror i të Dhënave Penale**

Financuar nga: Komisioni Evropian

Përfitues: KGJK, KPK, Gjykatat, Ministria e Drejtësisë

Qëllimi: Mbështetja në themelimin e data bazës qendrore me të dhënat penale

Implementues: Kosovo Legal Services Company

Kohëzgjatja: Janar 2017 – Janar 2020

Shuma e projektit: 2,500,000.00€

---

**Projektet të cilat mbështesin Ministrinë e Drejtësisë nga donatorë tjerë:**

**Programi për Fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë në Kosovë (PFSD)**

Financues: USAID

Përfitues: MD, KGJK, KPK

Qëllimi: Programi i USAID-it për fuqizimin e sektorit të drejtësisë në Kosovë është një program katërvjeçar për sundimin e ligjit që krijohet nga përpjekjet e mëhershme të USAID-it për avancimin e sundimit të ligjit në Kosovë dhe për të siguruar që sistemi i drejtësisë funksionon në mënyrë profesionale, efikase dhe llogaridhënese. PFSD përqendrohet në pavarësinë dhe paanshmërinë, integritetin, llogaridhënien, transparencën dhe integrimin e sistemit të drejtësisë.

Implementues: Millenium Development Partners Inc. (MDPI)

Kohëzgjatja: Nentor 2015 – Tetor 2019

Shuma e Projektit: 9.3 milion \$

Komponentët kryesorë:

- Fuqizimi i Efikasitetit dhe Efektivitetit në Administrimin e Drejtësisë dhe Ofrimin e Shërbimeve Cilësore;
- Zhvillimi I llogaridhënjes dhe Profesionalizmit të Sistemit të Drejtësisë;
- Mbështetja për Funkionim dhe Integrim të Strukturës Gjyqësore në Veri.

<https://www.usaid.gov/kosovo>

---

## **Programi për të Drejtat Pronësore (PRP)**

Financuar nga: USAID

Përfitues: KGJK, KPK, CMIS, MD

Qëllimi: Ky program është një iniciativë katër vjeçare për të përmirësuar kornizën ligjore dhe praktikën institucionale dhe procedurat që qeverisin të drejtat pronësore, në mënyrë që të bëjë më të lehtë ofrimin, regjistrimin, përdorimin dhe transferimin e pronës në Kosovë. Ky program mbështet Ministrinë e Drejtësisë në zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për të Drejtat Pronësore e cila do të adresojë çështjet thelbësore të pronës të cilat kanë peshë në rritjen ekonomike të vendit. Ky program gjithashtu, punon me gjykatat për të përmirësuar menaxhimin dhe gjykimin e rasteve të pronave.

Kohëzgjatja: Maj 2014 – Prill 2019.

---

Ministria e Drejtësisë ka filluar bashkëpunimin me Komitetin Holandez të Helsinkut për një periudhë 4 vjeçare (2018-2022).

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është që përmes projektit dhe metodologjive të përzgjedhura të bëhet përmirësimi i kushteve dhe ri-integrimi i të miturve. Ky projekt është dedikuar kryesisht për të miturit dhe stafin që punon me të miturit.

---

Shërbimi Korrektues i Kosovës ka qenë përfitues i disa donacioneve organizata HELP nga siç janë: pajisje për kuzhinën e Qendrës Edukuese-Korrektuese në Lipjan, pajisje për zdrukthëtari dhe bujqësi, pajisje të TI, etj., në vlerë prej 77,334.00 euro.

Gjithashtu, nga UNOPS është dhënë një material për prodhim në vlerë prej 33,473.80 euro. Ndërsa Kryqi i Kuq Ndërkombëtar janë dhuruar libra për të burgosurit në vlerë prej 1,252.24 euro, dhe nga ICITAP pajisje për TI në vlerë prej 4,576.65 euro.

UNICEF ka mbështetur ShKK-në duke ofruar donacion (furnizim me mobilje dhe pajisje për TI për Qendrën Edukuese-Korrektuese) në vlerë prej 6,768 euro.